



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT

“PËR OFRIMIN I EKSPERTIZËS PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË MBËSHTETJE TË KRIJIMIT TË MATERIALEVE TË VLERËSIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË, TRAJNIMIT TË EKSPERTËVE VLERËSUES TË JASHTËM DHE EKSPERTIZËS NË MBËSHTETJE TË VLERËSIMIT TË JASHTËM TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI”

Mars 2018

Përmbajtja

Mirëseardhja dhe Prezantimi.....	3
Roli i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA-së) në Mbretërinë e Bashkuar	3
Përmbledhje e metodës së vlerësimit të jashtëm.....	4
IAL-të e përfshira në proces	5
Veprimtaritë para vizitës	5
Përgatitja dhe menaxhimi i procesit: Manuali	5
Trajnimi i vlerësuesve të jashtëm.....	6
Sistemet e Menaxhimit të ASCAL-it (AMS, komunikimet).....	6
Përgatitja e RVV-së.....	7
Vetëvlerësimet	9
Anketimi i Studentëve dhe Stafit.....	9
Mbledhjet e grupit.....	11
Veprimtaritë e vizitës së vlerësimit të jashtëm.....	11
Vizita e vlerësimit të jashtëm, qëllimi dhe natyra	11
Mbledhjet.....	12
Evidencat.....	13
Arritja e përfundimeve dhe gjykimeve	13
Mbledhjet për arritjen e gjykimeve	13
Përfundimet dhe gjykimet e arritura për kontekstin shqiptar	14
Veprimtaritë pas vizitës	17
Hartimi i raportit të vlerësimit të jashtëm	17
Roli i Agjencive në komente dhe reagime	18
Rolet dhe performanca gjatë vlerësimit të jashtëm.....	18
Hyrje	18
Vlerësimi i vlerësuesve të jashtëm	19
Vlerësimi i kryevlerësuesve.....	19
Ekspertët e vlerësimit të jashtëm në përgjithësi.....	20
Roli i vlerësuesve të jashtëm shqiptarë	20
Vlerësimi i Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm	20

Mirëseardhja dhe Prezantimi

Kjo metodë u përgatit në vijim të Nismës së Qeverisë Shqiptare për Vlerësimin Institucional të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri (IAL-të) me anë të Ekspertizës Ndërkombëtare, në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar në dhjetor të vitit 2014 ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA) të Mbretërisë së Bashkuar, dhe të Kontratës së Përgjithshme të Projektit ndërmjet QAA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Objekti i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional ishte vlerësimi i shkallës së përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë nga çdo IAL, duke iu referuar standardeve dhe udhëzuesve mbi të cilat mbështetet akreditimi, për sigurimin e cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG). Raportet e përfuara të vlerësimit paraqisnin informacion të dobishëm jo vetëm për IAL-të, por edhe për Qeverinë Shqiptare, publikun dhe studentët se si secila IAL-ja i përmbush standardet. Qëllimi tjetër i procesit të vlerësimit ishte përkrahja e IAL-ve në punën e tyre drejt zhvillimit, pra përmirësimit sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave të mbështetjes së mësimnxënies së studentëve.

Vlerësimet institucionale u kryen në përputhje me një Manual, të përgatitur bashkërisht nga APAAL-i¹ dhe QAA-ja, duke marrë parasysh ESG-të².

Programi i vlerësimit i mundësoi APAAL-it dhe QAA-së ta përparonin partneritetin e tyre të suksesshëm dhe të mësonin rreth punës dhe kulturave në sigurimin e cilësisë së njëra-tjetrës.

Roli i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA-së) në Mbretërinë e Bashkuar

Ekspertiza dhe Ekspertët e QAA-së mbështetën vlerësimin e jashtëm të cilësisë së IAL-ve në Shqipëri. QAA-ja e mbështeti APAAL-in gjatë përgatitjes së metodës së vlerësimit dhe hartimit të dokumenteve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, duke përfshirë edhe Manualin dhe Shtojcat e tij.

Me mbështetjen e APAAL-it, QAA-ja trajnoi ekspertët vlerësues të jashtëm nga Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria, të cilët u përfshinë në kryerjen e vlerësimeve. Trajnimet bënë të mundur që vlerësuesit e QAA-së të njiheshin me arsimin e lartë në Shqipëri dhe me Standardet Shtetërore të Cilësisë, dhe që vlerësuesit shqiptarë të njiheshin me metodat dhe praktikën e vlerësimit.

Vlerësimet Institucionale u administruan nga APAAL-i dhe ishin në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri. QAA-ja vuri në dispozicion dhe trajnoi vlerësues nga Mbretëria e Bashkuar për grupin shqiptaro-britanik të vlerësimit të jashtëm. Secili grup vlerësimi u drejtua nga një ekspert i QAA-së. Në përfundim të vlerësimit, QAA-ja ofroi mbështetje që rekomandimet e raportit të vlerësimit të ishin të qarta

¹Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri, e cila sot njihet me emrin ASCAL

²<http://ascal.al/media/documents/publikime/manuali%20vleresimit%20institucional%20ial%202016.pdf>

dhe të mbështetura në prova nga proceset e vlerësimit të jashtëm, dhe përgatiti një përmbledhje të raporteve të vlerësimit të jashtëm në anglisht.

APAAL-i planifikoi veprimtaritë e vlerësimit të jashtëm dhe vizitat, vendosi ura komunikimi dhe siguroi vijimësinë e tij me IAL-të subjekt vlerësimi, koordinoi vlerësimet e jashtme, ofroi mbështetje administrative dhe logjistike, duke përfshirë mbajtjen e shënimeve dhe shërbimin e përkthimit, organizoi anketimet e studentëve dhe stafit në çdo IAL, grumbulloi të dhënat e përgjithshme institucionale nga çdo IAL, ofroi mbështetje gjatë fazës së analizimit të dokumenteve, duke pajisur me të dhëna institucionale, dërgoi projektraportet tek IAL-të dhe përgatiti raportet përfundimtare për Këshillin e Akreditimit. Krahas këtyre, APAAL-i e publikoi çdo raport në gjuhën angleze dhe shqipe.

Përmbledhje e metodës së vlerësimit të jashtëm

Vlerësimi Institucional ishte një proces katërfazor, në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, që konsistonte në vetëvlerësim, shqyrtim të dokumenteve, vizitë të vlerësimit të jashtëm dhe raport të vlerësimit të jashtëm.

Procesi filloi me vetëvlerësimin e IAL-ve dhe me dokumentet e përfuara nga Vetëvlerësimi, të cilat u dorëzuan pranë APAAL-it. Më pas, APAAL-i i ballafaqoi dokumentet e vetëvlerësimit të APAAL-it me të dhënat e tjera për përgatitjen e Dosjes së Vetëvlerësimit. Informacione të dhëna të tjera kuptojmë evidencat mbështetëse të marra nga baza e të dhënave të APAAL-it dhe pyetësorët e anketimeve për studentët dhe stafin, të menaxhuara, krahasuara dhe përmbledhura nga APAAL-i. Një grup ekspertësh vlerësues të jashtëm, jo të IAL-ve, të përbërë nga ekspertë të arsimit të lartë të emëruar nga APAAL-i dhe QAA-ja, mundësoi vlerësim të detajuar të Dosjes së Vetëvlerësimit. Gjatë vizitave të vlerësimit të jashtëm, vlerësuesit e jashtëm kërkuar informacione të tjera shtesë, sipas nevojave.

Grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi vizita në çdo IAL. Gjatë kësaj faze, vlerësuesit e jashtëm u takuan me përfaqësuesit e stafit, studentëve dhe palëve të tjera të interesit të IAL-së. Qëllimi i vizitës ishte verifikimi dhe shqyrtimi i të dhënave, fakteve dhe informacioneve në fusha të ndryshme, të caktuara nga vlerësuesit e jashtëm gjatë analizës paraprake. Kjo analizë mundësoi identifikimin e gjetjeve dhe arritjen në gjashtë gjykime, një për secilin nga pesë Fushat e Vlerësimit, dhe në një vlerësim të përgjithshëm nëse IAL-ja i përmbush standardet apo jo. Këto të dhëna u paraqitën me detaje në raportin e vlerësimit të jashtëm, shoqëruar me arsyetimin për secilin gjykim.

Procesi i vlerësimit të jashtëm u mbështet në përvojën e APAAL-it dhe QAA-së, dhe në parimet e parashtruara në Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë 2015 (ESG), sipas së cilave përgjegjësia kryesore për garantimin e cilësisë në arsimin e lartë i takon vetë IAL-ve. Gjithashtu, Udhëzimet rekomandojnë që i gjithë procesi të kryhet në pajtim të plotë me faktin se sa i ndryshëm mund të jenë sistemi i arsimit të lartë, institucionet dhe studentët, duke marrë parasysh nevojat dhe pritshmëritë, si dhe duke synuar zhvillimin dhe përmirësimin e mendësisë së cilësisë.

Ky raport vlerësimi mbështetet në disa veprimtari vlerësimi:

- Pyetësorët, që iu dërguan vlerësuesve të jashtëm, kryevlerësuesve dhe institucioneve të arsimit të lartë
- Një webinar me fokus grup, të mbajtur me pjesëmarrjen e kryevlerësuesve.
- Një mbledhje, të mbajtur në Londër më 12 janar 2018, ndërmjet APAAL-it dhe QAA-së.

IAL-të e përfshira në proces

Ky proces përfshiu 35 IAL në Shqipëri, si publike, ashtu edhe private. 19 IAL ishin universitete (12 publike dhe 7 private), 12 ishin institucione të arsimit të lartë/kolegje universitare (private), 3 ishin akademi (1 publike dhe 2 private) dhe 1 ishte kolegji profesional privat.

Për herë të parë në historinë e tyre, të gjitha institucionet publike (13) iu nënshtruan vlerësimit institucional. 10 nga 22 IAL private u përfshinë vullnetarisht në proces, duke përfshirë ato që e kishin marrë akreditimin institucional.

Veprimtaritë para vizitës

Siç parashikohet dhe në kontratën e përgjithshme ndërmjet MAS-it dhe QAA-së, dhe në kontratat individuale ndërmjet QAA-së dhe APAAL-it, faza përgatitore (07.03.2016-08.07.2016) ndahej në dy veprimtari kryesore:

Veprimtaria 1: Përgatitja e metodologjisë së vlerësimit dhe hartimi i Manualit

Veprimtaria 2: Përzgjedhja dhe Trajnimi i Vlerësuesve të Jashtëm

Përgatitja dhe menaxhimi i procesit: Manuali

Manuali “Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri” 2016-2017, u diskutua dhe u shtjellua në detaje ndërmjet dy agjencive (QAA-së dhe APAAL-it). Procesi filloi me takimin e parë informues më 21-22 mars 2016 në godinat e QAA-MB-së, në Gloucester, Mbretëri e Bashkuar, dhe rrjedhimisht përfundoi përmes komunikimeve online dhe në AMS (Sistemi i Menaxhimit të APAAL-it). Manuali në anglisht u përpilua më 17 maj 2016, më pas u përkthye nga APAAL-i në shqip, dhe më 30 maj 2016 u publikua në anglisht dhe në shqip.

Manuali u prezantua në një mbledhje zyrtare në 20.05.2016, ku morën pjesë përfaqësues nga 35 IAL-të e përfshira, dhe nga datat 21 deri në 30 maj 2016, u mbajtën një sërë mbledhjesh me rektorë dhe koordinatorë institucionale.

Pjesë e procesit ishte riorganizimi dhe ndarja e duhur e Standardeve Kombëtare për Vlerësimin dhe Akreditimin Institucional në Shqipëri në 5 Fusha Vlerësimi, të cilat ndihmuan për t'i kuptuar dhe për t'i përdorur ato në kontekstin e procesit të vlerësimit të jashtëm së bashku me QAA-në. QAA-ja ofroi ndihmesë thelbësore gjatë procesit, gjë që ndihmoi vetë procesin, dhe mundësoi që institucionet dhe organet e akreditimit (Bordi i Akreditimit) të kishin një ide më të qartë se si t'iu referoheshin standardeve për marrjen e vendimeve më të mira dhe të drejta për akreditimin.

Në kuadër të veprimtarisë së parë, APAAL-i në bashkëpunim me QAA-në, hartoi dy dokumente mbështetëse për vlerësimin e jashtëm: pyetësorët për stafin dhe studentët. Këto dokumente synonin përfundimin e reagimit dhe mendimeve të stafit akademik dhe studentëve të institucionit, të përfshirë në procesin e vlerësimit. Për përfundimin e reagimit, u përgatitën pyetësorë të ndarë për stafin akademik dhe studentët, në shqip dhe në anglisht. Pyetësorët u përdorën për procesin e vlerësimit të jashtëm të 35 IAL-ve subjekt vlerësimi dhe u përpunuan nga stafi i APAAL-it. Rezultatet e pyetësorit u morën në konsideratë nga Grupet e Vlerësimit të Jashtëm për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm. Në përfundim të vlerësimit dhe marrjes së vendimit të akreditimit, rezultatet iu përcollën të gjitha institucioneve.

Trajnimi i vlerësuesve të jashtëm

Përzgjedhja dhe trajnimi i vlerësuesve të angazhuar për Vlerësimin Institucional të IAL-ve shqiptare u krye gjatë periudhës prill-qershor 2016.

Gjatë procesit, u angazhuan vlerësues me përvojë nga QAA-ja dhe APAAL-i . Përzgjedhja dhe caktimi i vlerësuesve nga të dyja agjencitë u krye sipas kriterëve specifike të përcaktuara në Shtojcën 7 të Manualit. Lista e ekspertëve të përzgjedhur, e miratuar nga agjencitë përkatëse, përfshinte në total 34 ekspertë, 22 nga QAA-ja dhe 12 nga APAAL-i.

QAA-ja dhe APAAL-i përgatitën dhe hartuan një sërë dokumentesh dhe materialesh trajnimi për ekspertët. Trajnimi i ekspertëve të QAA-së u zhvillua më 7-8 qershor 2016, në Gloucester, MB, me pjesëmarrjen e tre përfaqësuesve të APAAL-it. Ekspertët e QAA-së u informuan rreth sistemit shqiptar të arsimit të lartë, profileve të IAL-ve, që iu nënshtruan vlerësimit institucional, metodologjisë së vlerësimit dhe çështjeve të tjera teknike dhe praktike të procesit. Me qëllim kuptueshmërinë dhe përdorimin më të mirë dhe të qartë në kontekstin e IAL-ve shqiptare, disa aspekte specifike të metodologjisë së përcaktuar në Manual, si Shtojca 4, 5, 6, 9 dhe 10, u përpunuan dhe diskutuan më tej.

Trajnimi i ekspertëve shqiptarë u organizua në dy faza: një seminar paraprak, i organizuar nga APAAL-i më 23 qershor dhe një trajnim dyditor më 29 dhe 30 qershor me dy ekspertë përfaqësues të QAA-së. Gjatë seancave të trajnimit, ekspertët shqiptarë falë informacionit të dhënë nga kolegët britanikë u njohën me metodologjinë e vlerësimit, teknikat e kërkimit të informacionit dhe komunikimit, rolin e drejtuesit të grupit dhe punën në grup në kontekstin e një vlerësimi cilësie, si dhe si të arrijnë një gjykim për fushën apo vlerësim të përgjithshëm mbështetur në rezultatet dhe gjetjet e vlerësimit të jashtëm.

Sistemet e Menaxhimit të ASCAL-it (AMS, komunikimet)

Procesi i vlerësimit u administrua përmes Sistemit të Menaxhimit të ASCAL-it (AMS). AMS është një platformë/sistem i brendshëm që përdoret për administrimin e procedurave, të dhënave institucionale dhe ndërkomunikimit me IAL-të, vlerësuesit e jashtëm dhe Këshillin e Akreditimit për vlerësimin e cilësisë dhe akreditimin e IAL-ve.

Kjo platformë e hartuar, përshtatur dhe përdorur tërësisht për këtë proces, për herë të parë edhe në anglisht, rezultoi një mjet i dobishëm dhe i efektshëm për të gjithë procesin dhe suksesin e tij. Përmes kësaj platforme, APAAL-i garanoi komunikimin midis IAL-ve dhe APAAL-it dhe Grupeve të Vlerësimit të Jashtëm, komunikimin e brendshëm dhe të koordinuar brenda APAAL-it për të gjitha vlerësimet për sa i takon grupimeve të raporteve dhe institucioneve të veçanta. AMS-ja mbështeti përgatitjen dhe diskutimin për mbledhjet virtuale midis APAAL-it dhe QAA-së, ndërmjet vetë anëtarëve të Grupit të Vlerësimit dhe me agjencitë përkatëse. Në të njëjtën kohë, ai u përdor edhe si një forum për diskutime, ndërveprime dhe shkëmbime të njohurive dhe përvojave të vlerësuesve të jashtëm në kuadër të të gjithë Projektit të Vlerësimit Institucional.

Përmes Sistemit të Menaxhimit të tij, APAAL-i administroi procedurat e vlerësimit për 35 IAL, 80 llogari aktive (stafi i ASCAL-it, koordinatorët institucionalë, vlerësuesit e jashtëm, Anëtarët e Bordit të Akreditimit, stafi i QAA-së), më shumë se 6500 dokumente si p.sh. raporte vetëvlerësimi dhe evidenca, më shumë se 5000 korrespondenca ndërmjet stafit, vlerësuesve dhe IAL-ve, si dhe më shumë se 300 dokumente të shkëmbyer ndërmjet vlerësuesve të jashtëm. AMS-ja mundësoi dhjetëra komunikime në kohë reale, informacione dhe shkëmbime të dhënash rreth IAL-ve, akses në kohë reale në të gjithë dokumentet në bazën e të dhënave të ASCAL-it. Përmes tij, u menaxhuan me sukses pyetësorët e stafit dhe të studentëve, dhe përgatitja e draftraporteve dhe raporteve përfundimtare deri te dhënia e vendimeve përfundimtare për akreditimin nga Bordi i Akreditimit.

Përgatitja e RVV-së

Procesi i Vlerësimit Institucional filloi me aplikimin zyrtar të Institucioneve të Arsimit të Lartë me ftesë/kërkesë të APAAL-it. Institucionet e pranuan në kohë ftesën e APAAL-it. Në proces u përfshinë edhe ato institucione që e kishin akreditim të vlefshëm.

Për qëllime të Vlerësimit Institucional, institucionet caktuan dhe emëruan një Koordinator Institucional. Koordinatorët Institucionalë ishin punonjës me kohë të plotë në institucionet përkatëse, dhe luajtën një rol të rëndësishëm gjatë të gjithë procesit. Ata ishin kontakti kryesor institucional dhe personi i kontaktit, përgjegjës për dokumentet dhe evidencat e dorëzuara pranë APAAL-it dhe Grupit të Vlerësimit të Jashtëm. Siç edhe përcaktohej në Manual, ata ishin të pranishëm dhe aktivë gjatë të gjitha mbledhjeve dhe përgjegjës për përmbushjen e kriterëve dhe respektimin e afateve nga IAL-ja, të caktuara nga APAAL-i dhe përmendur në manual. Në praktikë, Koordinatorët Institucionalë ofruan shumë ndihmë dhe mundësuan efikasitetin gjatë të gjithë procesit. Aktualisht, Koordinatorët Institucionalë emërohen si persona kyç të përhershëm për çdo procedurë të Sigurimit të Cilësisë, të drejtuar nga APAAL-i në kuadrin e vlerësimeve të zakonshme të jashtme në IAL-të shqiptare.

IAL-të ngritën një Grup Vetëvlerësimi (GVV), i cili koordinoi të gjithë procesin e vetëvlerësimit në institucion. Ky grup u angazhua dhe organizoi mbledhje gjatë vizitave të vlerësimit dhe asistoni në përfundimin e procesit të vlerësimit. Grupet e Vetëvlerësimit përbëheshin nga stafi i brendshëm me njohuri dhe kompetenca profesionale në Sigurimin e Cilësisë, nga përfaqësues të studentëve dhe nga palë të tjera të rëndësishme interesi në proceset e Sigurimit të Cilësisë në IAL-të e tyre.

Për sa i përket përfshirjes së studentëve, përveç rolit të tyre si anëtarë aktivë të GVV-së, ata u angazhuan si pjesëtarë aktivë në proces në mënyra të tjera:

- APAAL-i administroi një proces paralel me Vetëvlerësimin, duke marrë mendimet e studentëve përmes Pyetësorëve të Studentëve (Pyetësori), lehtësisht i aksesueshëm në portalin e studentëve në faqen e internetit të APAAL-it, i cili u plotësua në mënyrë anonime, për të garantuar konfidencialitetin gjatë të gjithë procesit;
- Gjatë vizitave të vlerësimit të jashtëm, mbledhjet me studentët ishin pjesë e axhendës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me studentët dhe alumnit në të gjithë IAL-të e përfshira në vlerësimin institucional, duke përdorur metoda dhe mënyra të ndryshme. Ata u pyetën për çështje të ndryshme lidhur me përfshirjen e studentëve në proceset e Sigurimit të Cilësisë, në vendimmarrje, si dhe në përfundimin e perceptimeve, mendimeve, vlerësimeve ose gjyqimeve të tyre rreth cilësisë akademike të institucionit.

Pas aplikimit të IAL-së, APAAL-i organizoi disa mbledhje me përfaqësuesit e saj: Rektorët, Koordinatorët Institucionalë dhe Grupet e Vetëvlerësimit. Mbledhjet me Grupet e Vetëvlerësimit u organizuan në terren në veçanti për çdo institucion. Qëllimi i këtyre mbledhjeve informuese ishte qartësimi i procesit të vlerësimit institucional për IAL-të, që të kuptohet vetë ai më mirë dhe rolet përkatëse. Ato i dhanë mundësinë APAAL-it të sqaronte informacione të veçanta rreth Raportit të Vetëvlerësimit, të dhënave, statistikave, provave dhe dokumenteve të kërkuara për procesin dhe për arritjen e një rezultati sa më të mirë. Krahas mbledhjeve të planifikuara, APAAL-i ka asistuar IAL-të, duke dhënë orientime dhe qartësime specifike dhe të mëtejshme gjatë të gjithë fazës së vetëvlerësimit përmes AMS-së.

Baza e të dhënave për Vlerësimin Institucional përfshinte një tërësi informacionesh, të dhënash, evidencash dhe dokumentesh, të përgatitura dhe të mbledhura në forma të ndryshme:

- Të dhëna të përgjithshme institucionale, dokumente të përgatitura paraprakisht nga APAAL-i, për të ndihmuar Grupin e Vlerësimit të Jashtëm për t'u njohur me prejardhjen, historinë e institucionit dhe kontekstin e arsimit të lartë në Shqipëri,
- Profilet e IAL-ve të përgatitura nga APAAL-i përmes Sistemit të Menaxhimit, mbështetur në të dhënat e grumbulluara nga IAL-ja për këtë proces;
- Rezultatet e pyetësorëve të studentëve dhe stafit, të administruar, krahasuar dhe përmbledhur nga APAAL-i gjatë fazës së Vetëvlerësimit dhe dorëzuar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm para fazës së analizës së të dhënave;
- Raporti i Vetëvlerësimit, i përgatitur nga IAL-të sipas formatit të dhënë në Shtojcën 5 të Manualit;
- Evidenca dhe dokumente mbështetëse të dorëzuara në anglisht dhe shqip, të cilat mbulonin një listë minimale informacioni, siç përcaktohet në Shtojcën 6 të Manualit.

IAL-të i dorëzuan dokumentet për Dosjen e Vetëvlerësimit të APAAL-it në dy mënyra: në format elektronik, duke i ngarkuar ato në sistemin AMS të APAAL-it, dhe në format të shtypur, duke i dërguar me postë ose personalisht. Versionin i shtypur përmbante një kopje të printuar dhe një CD me të gjithë përmbajtjen e Dosjes së Vetëvlerësimit.

Të gjitha IAL-të treguan interes, angazhim dhe përgjegjësi gjatë kësaj faze. Ata iu përmbajtën afateve të dorëzimit të RVV-së sipas specifikimeve në Manual dhe në Grafikonin e Vlerësimit të APAAL-it për IAL-të.

Vetëvlerësimet

IAL-të i përgatitën vetë raportet e vetëvlerësimit (RVV-të) sipas formatit të raportit të përcaktuar në manual. Raportet u kërkuan në shqip dhe në anglisht. Procesi i vlerësimit përfshinte shoqërimin e raporteve të vetëvlerësimit me evidenca dhe dokumente që mbështesnin pohimet e bëra në RVV. Institucionet duhet të siguruan që këto raporte dhe evidenca mbështetëse të ishin gjithëpërfshirëse dhe të adresonin çdo Fushë Vlerësimi në mënyrë që grupet të krijonin një ide të qartë rreth IAL-ve, proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë dhe mënyrës së përmbushjes së standardeve. IAL-të u nxitën të raportonin të dhënat, faktet dhe evidenca, që lidheshin vetëm me standardet, duke u siguruar që ato të evidentoheshin dhe të viheshin në dispozicion të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm. Gjithashtu, IAL-të duhet të shprehnin qartësisht se çfarë mendimi kishin rreth mënyrës së tyre të përmbushjes së standardeve dhe çfarë mund të bënin për t'i realizuar ato me më shumë efikasitet.

Vlerësuesit shqiptarë shprehën mendime përgjithësisht pozitive rreth cilësisë së vetëvlerësimeve institucionale, duke i cilësuar si të përshtatshme me objektivat që ato kishin.

Vlerësuesit dhe kryevlerësuesit e jashtëm të QAA-së shprehën mendime përgjithësisht pozitive për vetëvlerësimin, por nuk mbajtën të njëjtin qëndrim për dobinë e tij. Ata pranuan që disa prej tyre ishin përgatitur sipas standardeve të mira, por jo të gjitha IAL-të kishin njohuri me përgatitjen e dokumenteve të tilla. Megjithatë, në shumë prej vetëvlerësimeve, ata vunë re pak vetëreflektim, mungesë vëmendjeje të standardeve akademike dhe mungesë reference të evidencat mbështetëse. Vlerësuesit dhe kryevlerësuesit e jashtëm të QAA-së arritën në përfundimin se cilësia e përgatitjes së vetëvlerësimeve në gjuhën angleze ishte në disa raste e vështirë për t'u kuptuar.

Pothuajse çdo vlerësues dhe kryevlerësues ishte i mendimit se të Dhënat e Përgjithshme Institucionale ishin të dobishme, megjithatë njëri prej tyre vuri në dukje se jo të gjitha IAL-të e shfrytëzuan mundësinë për t'i analizuar dhe komentuar të dhënat.

Anketimi i Studentëve dhe Stafit

Dymbëdhjetë javë përpara çdo vlerësimi të jashtëm, APAAL- i administroi, krahasoi dhe përmbledhi pyetësorët e përgatitur për studentët dhe stafin, të cilët përmbanin pyetje rreth përvojës së punës/studimit pranë këtij institucioni.

Vlerësuesit e jashtëm konstatuan se në përgjithësi ato i përshtateshin qëllimit, por disa vlerësues ishin të mendimit se informacioni ishte i përgjithshëm, dhe disa të tjerë vinin në dyshim sinqeritetin e përgjigjeve. Njëri prej vlerësuesve sugjeroi që do të kishte qenë e dobishme marrja e informacioneve rreth popullsisë së të anketuarve. Të tjerë sugjeruan që do të kishte qenë e dobishme nëse rezultatet e pyetësorëve do t'iu ishin dërguar institucioneve, në mënyrë që Grupet e Vlerësimit të Jashtëm t'i diskutonin ato direkt në mbledhje, ose që pyetjet e pyetësorëve të ishin më të harmonizuara me Standardet Shtetërore të Cilësisë.

Rekomandim: të rishikohet qëllimi dhe përmbajtja e pyetësorëve të studentëve dhe stafit, për të garantuar përputhjen e rezultateve me qëllimet e vlerësimit.

Mbledhjet virtuale

Synimi i mbledhjeve virtuale me grupin ishte ofrimi i një mundësie si takimi i parë me Grupet e Vlerësimit të Jashtëm për të analizuar Dosjen e Vetëvlerësimit.

Mbledhjet e Grupit u realizuan përmes Skype-it, ku morën pjesë vlerësues nga Shqipëria, vlerësues nga QAA-ja dhe kryevlerësues nga QAA-ja, të cilët drejtuan takimin. Këto mbledhje kërkonin një nivel të caktuar të aftësive dhe kompetencave teknike, dhe megjithëse sistemi "Skype for Business" është mjaft i lehtë për t'u kuptuar dhe menaxhuar për ata që e përdorin, mund të jetë disi e mundimshme për një përdorues të ri. Për shumë prej pjesëmarrësve, ishte hera e parë që përdornin një teknologji të tillë dhe është për t'u theksuar fakti që për pjesën më të madhe, ishte një përvojë pozitive.

Sipas vlerësuesve shqiptarë, mbledhjet virtuale të grupit ishin të dobishme dhe nxitën komunikimin dhe ndihmuan në të kuptuarit të procesit nga ana e vlerësuesve të QAA-së.

Nga ana tjetër, vlerësuesit dhe kryevlerësuesit e jashtëm të QAA-së shprehën mendime të tjera, të cilat ishin disi të pritshme, duke pasur parasysh që zakonisht sipas përvojës së tyre takimi i parë zhvillohet bëhet ballë për ballë. Për disa vlerësues, mbledhjet virtuale të grupeve ishin shumë të kënaqshme, por të tjerë vunë në dukje kufizimet e teknologjisë, si dhe zhurmën e lartë në sfond dhe cilësinë e dobët të disa prej lidhjeve, vështirësinë për t'u angazhuar me të gjithë anëtarët e një takimi me shumë pjesëmarrës, mungesën e një axhende standarde për takimin, dhe vështirësitë e shkaktuara nga mosmbajtja e mbledhjeve në javët e caktuara.

Rekomandim: të miratohet një axhendë standarde për mbledhjet virtuale të grupeve dhe të sigurohet që të gjithë vlerësuesit të jenë në dijeni të tematikave të mbledhjes dhe oraret e saj.

Disa kryevlerësues organizuan një mbledhje virtuale me menaxherin e vlerësimit, e cila rezultoi të ishte e dobishme për planifikimin e vizitës në IAL. Të tjerë u shprehën se nuk ishin në dijeni të mundësisë së një mbledhjeje të tillë.

Rekomandim: të konsiderohet nëse mund të formalizohet mbledhja virtuale ndërmjet menaxherit të vlerësimit dhe kryevlerësuesit para vizitës së vlerësimit.

Dokumente shtesë

Grupet e Vlerësimit të Jashtëm iu kërkuar IAL-ve dokumentacion shtesë, që ata donin të shqyrtonin në vijim të analizës së Dosjes së Vetëvlerësimit, ose si rrjedhojë e pohimeve që kishin dëgjuar gjatë mbledhjeve të grupit. Grumbullimi i dokumenteve mbështetëse i dha mundësinë vlerësuesve t'i ndanin evidencat që mbështesnin përfundimet e tyre. IAL-ve iu kërkuar të dorëzonin dokumente shtesë sa më shpejtë të ishte e mundur duke respektuar afatet e caktuara nga Menaxherët e Vlerësimit.

Përgjithësisht, Grupet e Vlerësimit e vlerësuan pozitivisht saktësinë dhe respektimin e afateve nga IAL-të në përmbushjen e këtyre kërkesave. Megjithatë, disa prej vlerësuesve vunë në dukje që IAL-të nuk i dorëzuan dokumentet brenda datës së kërkuar, ose nuk i dorëzuan fare ato. Për rrjedhojë, mund të sugjerohet që menaxherët e vlerësimit të jenë më këmbëngulës dhe të prerë për kërkesat e tyre lidhur me dokumentacion. Disa IAL i dorëzuan dokumentet vetëm në shqip, gjë që ishte e lejueshme, por solli probleme për disa prej vlerësuesve të QAA-së, pasi ata duhet të mbështeteshin vetëm tek eksperti shqiptar për vlerësimin e dokumentit.

Përgjithësisht, vlerësuesit shqiptarë ishin të kënaqur me dokumentacionin shtesë të dorëzuar, por disa prej tyre do të kishin preferuar që vizita në IAL të kishte zgjatuar më shumë, gjë që

nënkupton se vizita në vetvete mund të konsiderohet si burimi i parë i provave. Ndoshta mund të jetë e dobishme të jepen udhëzime për vlerësuesit e ardhshëm rreth qëllimit të analizës paraprake dhe vizitës së vlerësimit të jashtëm.

Megjithatë, komente të shumta nga vlerësuesit dhe kryevlerësuesit e jashtëm të QAA-së rreth dokumenteve shtesë sugjeruan që ato e shtuan lodhjen gjatë punës. Ne besojmë se vlerësuesit e QAA-së janë mësuar me praktikën e vlerësimit paraprak për të arritur në disa përfundime paraprake, dhe e shohin vizitën si mënyrë për t'i konfirmuar këto përfundime. Për këtë arsye, ata i dhanë rëndësi të veçantë dorëzimit të dokumentacionit të plotë dhe në kohë .

Reagimi nga IAL-të vuri në dukje të të kuptuarit të qartë të kërkesave për informacione shtesë, dhe komente pozitive rreth mënyrës se si trajnimet i kishin përgatitur për këtë. Dy IAL theksuan pjesën e përkthimit të provave në anglisht dhe burimet që nevojiteshin për këtë shërbim.

Mbledhjet e grupit

Grupet e Vlerësimit të Jashtëm organizuan mbledhje ballë për ballë në Shqipëri para vizitës së vlerësimit të jashtëm, për të konfirmuar planifikimet për vizitën, për të rënë dakord për axhendat dhe tematikat që do të diskutoheshin gjatë vizitës, dhe për të konfirmuar përgjegjësitë e çdo anëtari të grupit. Kjo i ofronte më shumë mundësi vlerësuesve të jashtëm për të diskutuar rreth analizës së Dosjes së Vetëvlerësimit.

Vlerësuesit e jashtëm i konsideronin të dobishme këto mbledhje dhe, me përjashtim të njërit vlerësues, të gjithë i vlerësuan ato përshtatshme me objektivin e tyre. Vlerësuesit theksuan që kontributi i anëtarëve shqiptarë të grupit dhe njohuritë e tyre për kontestin ishin mjaft ndihmuese. Megjithatë, vlerësuesit konstatuan problematika rreth orarit, vendndodhjes dhe përfundimeve të këtyre mbledhjeve.

Organizimi i axhendës është një element thelbësor i vizitës së vlerësimit të jashtëm, ndaj një mbledhje e të gjithë grupit të vlerësimit është shumë e rëndësishme për të garantuar që të gjitha nevojat e çdo anëtari mbulohen dhe merren në konsideratë në axhendë. Gjithashtu, është vërtetë e rëndësishme të sigurohet se të gjithë anëtarët e grupit janë gati për fillimin e vizitës. Është e rëndësishme ndjekja e një qasjeje disi më formale lidhur me planifikimin dhe drejtimin e mbledhjes së grupit, për arritjen e objektivit. Mbledhja e grupit të vlerësimit të jashtëm mund të ketë përfitimi nga një axhendë e standardizuar, pritshmëri të qarta për përfundimet, pritshmëri të qarta të çdo anëtari të grupit, si dhe përcaktim të një kohëzgjatjeje reale dhe një vendtakimi të përshtatshëm, ndoshta në godinat e vetë IAL-ve.

Rekomandim: të rikonsiderohet mënyra e organizimit të mbledhjeve ballë për ballë që kryhen para vizitës.

Veprimtaritë e vizitës së vlerësimit të jashtëm

Vizita e vlerësimit të jashtëm, qëllimi dhe natyra

Vizitat e vlerësimit të jashtëm zgjatën nga 1.5 deri në 3 ditë, në varësi të shkallës dhe kompleksitetit të institucionit, si dhe numrit të njëjësive dhe të studentëve. Vizitat iu mundësuan ekspertëve të vlerësimit mbledhjen dhe analizimin e fakteve, verifikimin e informacioneve të

paraqitura në raportin e vetëvlerësimit, konstatimin e gjetjeve në secilën prej Fushave të Vlerësimit, si dhe arritjen e një gjykimi të përgjithshëm.

Një sërë ekspertësh shqiptarë shprehën mendimin se IAL-të do të përfitonin nga njohja më e mirë e synimeve dhe qëllimeve të procesit të vlerësimit të jashtëm, dhe se Grupi i Vlerësimit të Jashtëm do të përfitonte më shumë nëse do ta kuptonin më mirë kontekstin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Shumë ekspertë të QAA-së dhe kryevlerësues thanë fjalë të mira për aspektet pozitive të vizitave të vlerësimit të jashtëm, lidhur me bashkëpunimin me kolegët në sisteme të ndryshme të arsimit të lartë dhe me shkallën e lartë të angazhimit të IAL-ve në procesin e vlerësimit të jashtëm.

Megjithatë, disa prej tyre shprehën mendimin se disa IAL e konsideronin vlerësimin e jashtëm si ushtrim që duhej bërë dhe jo si një mundësi për vetëvlerësim reflektues. Kjo mbështet pikëpamjen e shprehur më sipër, që disa nga vetëvlerësimet nuk kishin natyrë mjaftueshëm reflektuese.

IAL-të u shprehën përgjithësisht pozitivisht për përgatitjen e vizitave, si dhe për sjelljen dhe profesionalizmin e grupeve të vlerësimit të jashtëm. Ata theksuan komunikimin e mirë me grupin, nivelin e lartë të organizimit të vizitës dhe qartësinë e metodologjisë.

Ekspertët e QAA-së ndoqën praktikën e shqyrtimit të përfundimeve në fushat e tyre të caktuara përpara vizitës, në mënyrë që të identifikonin dokumentet shtesë që duhet të konsultonin dhe të kërkonin. Kjo do të thotë se shumë ekspertë të QAA-së e përdorën vizitën e vlerësimit të jashtëm për të qartësuar hollësitë dhe për të sfiduar gjetjet e tyre paraprake.

Mbledhjet

Koordinatorët institucionalë ishin përgjegjës për sigurimin e disponueshmërisë së punonjësve të IAL-ve që vlerësuesit kishin kërkuar të takonin dhe pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet përkatëse. Vizitat e vlerësimit të jashtëm përfshinin mbledhje me drejtuesit dhe administratorët e IAL-së, stafit të sigurimit të cilësisë, stafit akademik dhe administrativ, dhe studentët. Nga fundi i vizitave të vlerësimit të jashtëm, grupet e vlerësimit zhvilluan mbledhjet e fundit me anëtarët e stafit me përvojë në IAL, për të përmbledhur pikat kryesore të vlerësimit dhe për t'i dhënë IAL-së një mundësi të fundit në mënyrë që të qartësonin ose të paraqisnin evidencat që do ta ndihmonin grupin e vlerësimit të arrinte në gjetje përfundimtare.

IAL-të dhe ekspertët u shprehën pozitivisht për organizimin e vizitave dhe për mundësitë e paraqitjes së evidencave dhe përfshirjes në diskutime. Ata u shprehën pozitivisht edhe për organizimin e mbledhjeve, duke thënë se kishte mjaft mundësi diskutimi ndërmjet grupit të vlerësimit, stafit dhe studentëve. Reagimi i përfutur prej anketimeve tregoi se marrëdhëniet ndërmjet menaxherëve të vlerësimit dhe koordinatorëve institucionale ishin pozitive dhe efikase.

Ekspertët e QAA-së ishin përgjithësisht të kënaqur me përgatitjen e mbledhjeve, mundësitë për të dëgjuar mendimet e stafit të IAL-ve, dhe ishin shumë të kënaqur me bashkëpunimin e tyre dhe të studentëve gjatë vlerësimit, si dhe me ndihmën e ofruar nga koordinatorët institucionalë. Megjithatë, pati një rast kur një nga mbledhjet e vlerësimit të jashtëm u ndërpre dhe turet nëpër mjedise po zgjatëshin më tepër seç ishte planifikuar, duke theksuar kështu rëndësinë (dhe

vështirësinë) e kryerjes së veprimtarive të vlerësimit të jashtëm sipas planit. Disa mendonin se nuk kishin kohë të mjaftueshme në dispozicion, kryesisht prej përkthimit në gjuhën shqipe dhe angleze gjatë mbledhjeve. Në anketim, gjysma e kryevlerësuesve shprehën vërejtjet e tyre lidhur me punën me dy gjuhë, e cila sipas tyre mund të sillte ngatërresa dhe shfrytëzim joefikas të kohës. Në këtë drejtim mund të nevojiten udhëzime ose trajnime të mëtejshme, ose përkthimi simultan.

Evidencat

Në çdonjërin prej vlerësimeve të jashtme, u vërejt qasja e arritjes në përfundime duke u mbështetur në evidencat. Disa prej evidencave u konsideruan si Informacione Thelbësore sipas kërkesës dhe u renditën në Aneksin 6 të Manualit. Evidencat përfshinin edhe të Dhënat e Përgjithshme Institucionale të hartuara nga APAAL-i, rezultatet e anketimeve të stafit dhe të studentëve, si dhe procesverbalet e mbledhjeve të zhvilluara në IAL.

Gjatë vizitave të vlerësimit të jashtëm, IAL-të ofruan evidencat shtesë në përgjigje të kërkesave të grupeve të vlerësimit të jashtëm. Gjatë anketimit të vlerësimit, ekspertët pohuan se ofruesit kishin mjaft mundësi për t'i paraqitur evidencat gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm. Kjo nuk nënkuptonte se IAL-ja i kishte ofruar informacionet, por që kishin mundësinë për ta bërë këtë gjë. Të gjithë vlerësuesit e jashtëm, përveç njërit, u shprehën pozitivisht për faktin se evidencat ishin të bollshme për të dalë në përfundime dhe gjykime të shëndosha. Ndonjëherë evidencat e ofruara gjatë vizitave ishin të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe, dhe vlerësuesve nga Mbretëria e Bashkuar iu duhej të mbështeteshin te vlerësuesit e jashtëm shqiptarë për të kontrolluar saktësinë dhe besueshmërinë e dokumentit, gjë që nuk e kishin parashikuar. Një tjetër kryevlerësues vërejt se megjithëse mbledhja e të gjitha informacioneve shtesë, të marra gjatë vizitave të vlerësimit të jashtëm, nga Menaxheri i Vlerësimit ishte e dobishme, jo të gjitha evidencat ishin ruajtur, renditur dhe hedhur në faqen e APAAL-it, duke e vështirësuar referimin e tyre në raport, dhe në këtë drejtim do të kishte qenë më e dobishme po të kishte pasur më shumë disiplinë.

Arritja e përfundimeve dhe gjykimeve

Mbledhjet për arritjen e gjykimeve

Në fund të vizitave të vlerësimit të jashtëm, grupet e vlerësimit të jashtëm zhvilluan mbledhje me detyrë të mbyllura për të dalë në përfundime. Ato përfshinin vlerësimin e evidencave për të arritur në gjetje dhe përfundime për çdo Fushë Vlerësimi.

Në përgjithësi, Vlerësuesit e jashtëm shqiptarë dhe të QAA-së ishin dakord me faktin se mbledhjet për arritjen e gjykimit ishin zhvilluar në përputhje me Manualin dhe në një farë mënyre sollën arritjen e gjykimeve të shëndosha. Megjithatë, disa prej tyre u shprehën se natyra dhe formulimi i Standardeve e vështirësonte vijimësinë e diskutimeve vetëm në kuadrin e Standardit përkatës. Për ekspertët e QAA-së, në këtë drejtim mund të ketë kontribuar ndryshimi midis natyrës së standardeve shqiptare me ato të Mbretërisë së Bashkuar. Vlerësimi i jashtëm, gjykimet dhe raporti do të luajnë rol tejet të rëndësishëm në marrjen e vendimit nga Këshilli i

Akreditimit, gjë që duhet theksuar për vlerësuesit e jashtëm e QAA-së. Të dobishme mund të jenë edhe udhëzimet shtesë, si dhe shembujt mbi interpretimin e Standardeve në kontekstin e sistemit shqiptar.

Përfundimet dhe gjykimet e arritura për kontekstin shqiptar

Sipas metodologjisë së ndjekur, Standardet Shtetërore të Cilësisë ndahen në pesë fusha vlerësimi, siç paraqitet në Manual.

- 1 Organizimi dhe Menaxhimi i tij
- 2 Burimet
- 3 Kurrikula
- 4 Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi
- 5 Studentët dhe Mbështetja e tyre

Gjykimet për secilën Fushë Vlerësimi ndaheshin me 4 nivele dhe shpreheshin si më poshtë:

- i. Standardet për [fusha] janë përmbushur plotësisht
- ii. Standardet për [fusha] janë përmbushur kryesisht
- iii. Standardet për [fusha] janë përmbushur pjesërisht
- iv. Standardet për [fusha] nuk janë përmbushur.

Për arritjen e këtyre gjykimeve, ekspertët filluan me konsolidimin e gjetjeve për secilën Fushë Vlerësimi. Gjetjet u kategorizuan si më poshtë:

- karakteristikat e praktikës së mirë;
- dobësitë;
- rekomandimet për veprim nga IAL-ja (të klasifikuara sipas shkallës së urgjencës me që grupi mendonte se duhej trajtuar çdo rekomandim);
- pohime të rrjedhës së veprimeve të identifikuara tashmë nga IAL-ja.

Mbështetur në gjykimin dhe gjetjet për secilën Fushë Vlerësimi, grupi i vlerësimit të jashtëm do të arrijë në një gjykim përmbledhës për të gjithë Vlerësimin e Jashtëm Institucional, që do të shprehet si më poshtë:

- i. Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht
- ii. Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht
- iii. Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht
- iv. Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.

Vlerësuesit e jashtëm u bazuan në informacionet e mëtejshme për metodologjinë, në mënyrë që të arrinin në një gjykim të përgjithshëm, i cili gjendet në Aneksin 11 të Manualit.

Vlerësuesit e jashtëm, si ata shqiptarë ashtu edhe ata të QAA-së, së bashku me kryevlerësuesit garantuan se për arritjen e gjykimit, ishin bazuar te Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe në Aneksin 10 të Manualit tyre, me përjashtim të disa komenteve të veçanta lidhur me faktin se manualit nuk i ishte dhënë përparësia e duhur. Megjithatë, komentet e tyre dhe formulimi i raporteve sugjerojnë se mund të ketë hapësirë për përmirësimin e formulimit dhe strukturës së Standardeve, si dhe të udhëzimeve që i janë dhënë për grupet e vlerësimit të jashtëm.

- (a) Vlerësuesit e jashtëm të QAA-së dhe kryevlerësuesit shprehën qartësisht mendimin e tyre se nevojitet një paketë e qartë Standardesh. Ekspertët theksuan mbivendosjen Standardeve dykuptimësinë e elementëve që trajtoheshin në secilin standard dhe mungesën e udhëzimeve për mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të Standardeve. Disa IAL shprehën mendime të ngjashme lidhur me paqartësinë dhe/ose përsëritjen e disa prej Standardeve.

Rekomandim: Të rishikohet formulimi i Standardeve për të siguruar qartësi dhe mospërsëritje

- (b) Manuali identifikon "Shembuj të Praktikës së Mirë", të cilët mund të mbështesin përbushjen e çdo Standardi. "Udhëzimet Shtesë për Vlerësuesit e Jashtëm" bëjnë dallimin midis praktikës që përbush kriteret për gjetjen e "Praktikës së Mirë" dhe praktikës thjesht i përbush "Udhëzimet e Standardeve". Megjithatë, disa raporte shfaqën ngatërresa lidhur me interpretimin e "Shembujve të Praktikës së Mirë". Kjo mund të ketë kontribuar në larminë e Karakteristikave të Praktikës së Mirë, që janë identifikuar në IAL të ndryshme, që luhateshin nga 0 në 16. Nuk ka evidenca që tregojnë se grupet e vlerësimit të jashtëm nuk kanë arritur të japin gjykime të mira për sa i përket identifikimit të Karakteristikave të Praktikës së Mirë.

Udhëzimet Shtesë pohojnë që Praktika e Mirë:

- duhet t'i referohet praktikës në IAL dhe jo praktikave të tjera;
- duhet të mbështetet vazhdimisht me evidenca;
- duhet të shkojë përtej pritshmërive bazë;
- duhet të jetë praktikë që një IAL mund ta zbatojë në të gjitha veprimtaritë e saj në të mirë të studentëve.

Gjithashtu, mund të shtohet se formulimi i Praktikës së Mirë mund të përmbajë një tregues të ndikimit të saj, pra dobitë që sjell kjo praktikë e mirë. Qartësimi i ofruar në Udhëzimet Shtesë për Praktikën e Mirë, ndërkohë që kishte qëllim të mirë, duket se ka ngatërruar ata që janë informuar fillimisht në trajnim për Praktikën e Mirë.

Për të siguruar vijimësinë, do të ishte e dobishme të përfshihej një përkufizim më i qartë i "Praktikës së Mirë" në Manualin e radhës, duke përfshirë aspektet e referuara në "Udhëzimin Shtesë për Vlerësuesit e Jashtëm".

Rekomandim: Të zëvendësohet emërtimi "Praktikë e Mirë" në Standardet Shtetërore të Cilësisë me "Praktikë e Shëndoshë" ose "Praktikë Bazë" për të shmangur ngatërresat

Rekomandim: Manuali të përmbajë një përkufizim të qartë të "Praktikës së Mirë"

- (c) Megjithëse Manuali thekson rolin e Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane (ESG) për vlerësimin e zbatimit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë nga IAL-ja, asnjëri nga vlerësuesit e jashtëm nuk e përmendi përfshirjen e ESG-së në ndonjë vlerësim ose raport. Në këto të fundit, raporte ajo thuajse nuk përmendet fare. Kjo nënkupton se grupet e vlerësimit të jashtëm duhet ta mbështeten më shumë te ESG-ja gjatë punës së tyre.

Rekomandim: Të shikohet nëse parapëlqehet përmendja e ESG-së; nëse po të përmirësohen udhëzimet për grupet e vlerësimit të jashtëm, ose formulimi i kriterëve të gjykimit.

- (d) “Udhëzimi Shtesë për Vlerësuesit e Jashtëm” kërkon që raportet të identifikojnë shkallën e urgjencës me të cilën duhet trajtuar një rekomandim. Pavarësisht këtij udhëzimi, shumë grupe të vlerësimit të jashtëm nuk arritën ta bënin këtë gjë në projektraportet e tyre. Kjo ia vështirëson IAL-ve prioritizimin e elementëve të përgjigjes ndaj raportit, duke dobësuar me shumë gjasa përmirësimin e përvojës së studentëve. Nëse “Udhëzuesi Shtesë për Vlerësuesit e Jashtëm” do të qartësonte se në cilat mënyra grupi i vlerësimit të jashtëm përcakton shkallën e “urgjencës”, p.sh. duke përcaktuar datën se kur duhej të ishte përbushur rekomandimi, do të sigurohej qëndrueshmëria në raportim.

Rekomandim: Udhëzimi për grupet e vlerësimit të jashtëm të qartësojë se si mund të shprehet shkalla e urgjencës së rekomandimeve.

- (e) Udhëzimi nuk kërkon që raportet të përfshijnë shtjellimin e bazës mbi të cilën janë arritur gjykimet. Në përputhje me Manualin, në përgjithësi, raportet nuk identifikojnë qartazi Standardet e përbushura apo të papërbushura. Si rrjedhojë, raportet nuk janë transparente lidhur me shpjegimin se si janë përdorur kriteret e gjykimit në Aneksin 10 të Manualit për të dalë në një përfundim. Ndryshimet në udhëzimin e këtij Manuali në këtë drejtim do të mundësonin një transparencë më të madhe në raporte.

Rekomandim: Të vlerësohet nëse duhet rritur transparenca duke kërkuar shpjegimin e mënyrës se si janë përdorur kriteret e gjykimit për të dalë në përfundime në raporte

- (f) Manuali nuk sugjeron se duhet bërë dallimi midis rëndësisë së Standardeve të ndryshme. Megjithatë, disa prej tyre mund të konsiderohen si pjesë thelbësore e një sistemi arsimor të shëndoshë, ndërsa të tjerë mund të konsiderohen si kontribues në përmirësim. IAL-të mund të përfitojnë nga udhëzimet lidhur me faktin nëse standardet e veçanta janë të detyrueshme. Nga ana tjetër, kjo mund të kërkojë udhëzime të ndryshme për strukturën e raporteve, për të siguruar se ato përfshijnë si përshtatjen e elementëve të detyrueshëm, ashtu edhe vlerësimin lidhur me masat e IAL-së për përmirësim.

Rekomandim: Të vlerësohet nëse standardet duhet të identifikohen si “të detyrueshme” ose “të mbështetura në përmirësim”; nëse po, duhet të vlerësohet nëse kriteret e gjykimit duhet të përshtaten sipas nevojës.

- (g) Dy IAL shprehën shqetësimin se në këtë aspekt, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk i kishte marrë parasysh aq sa duhet dokumentet që i ishin paraqitur, ose i kishte shpërfillur komentet e IAL-së për projektraportin. Këto shqetësime mund të jenë pasojë e mungesës së transparencës në paraqitjen e përfundimeve, siç përmendet më sipër në pikën (e).

Veprimtaritë pas vizitës

Hartimi i raportit të vlerësimit të jashtëm

Pas vizitës në mjediset e IAL-së, grupi i vlerësimit të jashtëm hartoi raportet e vlerësimit në gjuhën angleze. Përgatitja e raporteve nisi gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm dhe vazhdoi përmes komunikimit me shkrim midis anëtarëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Kryevlerësuesit e bashkërenduan këtë proces me ndihmën e Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm.

Raportet u përpiluan në mënyrë të përmbledhur, megjithëse kufiri i fjalëve u rrit nga 12,000 në 17,000 pas fashës së parë. Kjo iu mundësoi grupeve ofrimin e mjaft hollësive ,për t'u marrë parasysh në shkallën më të lartë të mundshme nga IAL-ja dhe Këshillit të Akreditimit. Raportet ofruan informacione përshkruese dhe vlerësuese për secilën IAL në mënyrë të përmbledhur dhe lehtësisht të aksesueshme, gjetje të mbështetura në evidencat e duhura dhe të identifikueshme, si dhe rekomandime të qarta të mbështetura me evidenca.

Raportet u hartuan sipas modelit të raportit të vlerësimit të jashtëm, të paraqitur në Aneksin 12 të Manualit, të cilat mbulonin pesë Fushat e Vlerësimit, si dhe parashtronin gjetjet e grupit të vlerësimit të jashtëm lidhur me secilën prej këtyre fushave. Në fund paraqitej gjykimi përmbledhës. Përmbajtja e raportit u miratua nga të gjithë anëtarët e grupit. Përdorimi i një modeli për hartimin e raportit ishte i dobishëm për ruajtjen e një linje në të gjitha raportet.

Kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e jashtëm u shprehën kryesisht pozitivisht për procesin e hartimit të raporteve, duke përfshirë faktin se u zhvillua në kohën e duhur dhe se raportet mbështeteshin në evidenca të bollshme, duke përfshirë edhe pyetësorët e stafit dhe studentëve.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm tërhoqën vëmendjen për një sërë fushash rreth të cilave duhet reflektuar.

- (a) Ndonëse ishin pozitive, përgjigjet nga kryevlerësues të vlerësimit të jashtëm në anketim treguan një ndryshim lidhur me cilësinë e tekstit të raportit nga kolegët e tyre. Kryevlerësuesit ishin përgjegjës për kthimin e tekstit të vlerësuesve të jashtëm në një raport të vetëm dhe u shprehën pozitivisht për këtë rol. Megjithatë, disa prej kryevlerësuesve mendonin se kjo detyrë ishte sfiduese dhe përmendën arsye, si: mungesa e përvojës së vlerësuesve të jashtëm shqiptarë për sa i përket mënyrës së hartimit, si dhe mungesa e zotërimi jo i mirë i në gjuhës angleze në të shkruar. Disa kryevlerësues kaluan shumë kohë duke e redaktuar tekstin e përgatitur nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm. Sidoqoftë, ekspertët shqiptarë u shprehën pozitivisht për natyrën e hapur të diskutimeve në grup gjatë përgatitjes së raporteve, si dhe për bashkëpunimin midis grupeve të vlerësimit të jashtëm.

Rekomandim: Trajnim i mëtejshëm i ekspertëve të rinj për hartimin e raporteve , dhe/ose trajnim individual për ekspertët e rinj gjatë hartimit të raportit të parë

- (b) Përgjithësisht, kryevlerësuesit ishin të kënaqur me nivelin dhe natyrën e evidencave mbi të cilat vlerësuesit e jashtëm u mbështetën për arritjen e përfundimeve. Edhe kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e jashtëm ishin përgjithësisht të kënaqur me mënyrën

sesi ishin përdorur rezultatet e anketimit të stafit për të mbështetur përfundimet, por shprehën pakënaqësi për shkallën e ulët të përgjigjeve.

Rekomandim: Të merret parasysh vënia në dispozicion e anketimeve të stafit dhe studentëve për IAL-të për të marrë komentet e tyre dhe për të bërë përmirësime përpara vizitës së vlerësimit të jashtëm

- (c) Për përgatitjen e raporteve u përcaktua një program i qartë, dhe si ekspertët e vlerësimit të jashtëm ashtu edhe kryevlerësuesit mendonin përgjithësisht se programi u respektua, përveç disa rasteve. Reagimet tregojnë se në disa raste të veçanta nuk janë përmbushur afatet e parashikuara dhe ekspertët sugjerojnë se kjo ishte për shkak të faktit se disa nuk arrinin ta llogarisnin kohën e nevojshme për hartimin e raportit dhe të trysisë së të punuarit me disa raporte njëkohësisht.
- (d) Manuali përfshin udhëzime të qarta dhe të drejtpërdrejta për strukturën, mbi të cilën bazohen në përgjithësi raportet. As ekspertët e vlerësimit të jashtëm dhe as kryevlerësuesit nuk bënë komente lidhur me këtë udhëzim, gjë që tregon se e kanë parë si të dobishëm dhe të përshtatshëm për sigurimin e plotësisë dhe konsistencës së raporteve. Në projektraporte kishte një mospërputhje për përfshirjen ose mospërfshirjen e një liste me evidenca. Përfshirja e tyre duhet të jetë rregull në mënyrë që IAL-të të kuptojnë lehtësisht referencat e dokumenteve në raport.

Roli i Agjencive në komente dhe reagime

QAA i mundësoi anëtarëve të pavarur të stafit të lexonin dhe të jepnin komente për raportet përpara finalizimit të tyre. Disa kryevlerësues u shprehën pozitivisht për natyrën e dobishme të komenteve të tyre, ndërsa njëri prej tyre theksoi se komentet tregonin mosnjohjen e sistemit e arsimit të lartë në Shqipëri. Gjithashtu, kryevlerësuesit thanë se APAAL, duke përfshirë menaxherët e vlerësimit të jashtëm, nuk kontribuoi në përgatitjen e raporteve, megjithëse i kishin projektraportet në dispozicion. Qartësimi i rolit të menaxherit të vlerësimit të jashtëm, nëse ka, në përpilimin e projektraportit, krahas paraqitjes së tij tek IAL-ja përkatëse mund të jetë e dobishme.

Rekomandim: Të qartësohet i rolit të menaxherit të vlerësimit të jashtëm në finalizimin e raportit.

Rolet dhe performanca gjatë vlerësimit të jashtëm

Hyrje

Grupet e vlerësimit të jashtëm përbëheshin nga tre deri në gjashtë ekspertë të vlerësimit të jashtëm, në varësi të përmasave, qëllimit dhe kompleksitetit të IAL-së nën vlerësim. Secili grup përfshinte të paktën dy ekspertë të vlerësimit të jashtëm të caktuar nga QAA-ja nga një IAL në Mbretërinë e Bashkuar, dhe të paktën një ekspert të caktuar nga APAAL-i nga një IAL në Shqipëri. Manuali parashtron kriteret për emërim.

'Ekspertët e vlerësimit të jashtëm të caktuar nga QAA janë përgjithësisht anëtarë me përvojë shumëvjeçare të stafit të një IAL-je në Mbretërinë e Bashkuar në mësimdhënie, në vlerësimin e cilësisë në institucionin e tyre dhe në vlerësimin e jashtëm sipas metodave të QAA-së.'

Në të gjitha rastet, **Kryevlerësuesit** ishin anëtarë britanikë të grupit të vlerësimit të jashtëm, duke drejtuar bashkërendimin dhe komunikimin e punës së grupit. Përpos kësaj, Kryevlerësuesi drejtoi mbledhjet e grupit, si dhe hartoi dhe redaktoi raportin e tij.

Kryevlerësuesit mbanin, ose sapo ishin larguar nga pozicione të larta në një IAL në Mbretërinë e Bashkuar, kishin përvojë shumëvjeçare në menaxhimin e cilësisë në institucionin e tyre, si dhe kishin një historik të pasur të punës cilësore disavjeçare në vlerësimin e jashtëm me metodat e QAA-së..

Menaxheri i Vlerësimit të Jashtëm ishte anëtar i stafit të APAAL-it, i cili monitoroi ecurinë e vlerësimit të jashtëm, lehtësoi punën e grupit të vlerësimit të jashtëm, dhe këshilloi IAL-në për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Vlerësimi i vlerësuesve të jashtëm

Në përgjithësi, vlerësuesit e jashtëm shqiptarë u shprehën pozitivisht për përvojën me vlerësuesit nga Mbretëria e Bashkuar, duke nënvizuar nivelin e lartë të punës në grup, natyrën e hapur dhe transparente të procesit, si dhe përvojën dhe ekspertizën e vlerësuesve të jashtëm të QAA-së.

Edhe vlerësuesit e jashtëm të QAA-së u shprehën përgjithësisht pozitivisht për punën e grupit të tyre. Megjithatë, një anëtar i grupit të vlerësimit dhe dy kryevlerësues theksuan sfidat e hasura nga vlerësuesit e jashtëm shqiptarë, si vështirësia për të punuar në gjuhën angleze për të bashkëpunuar në grup dhe për të marrë pjesë në diskutime të hapura.

Grupet e vlerësimit të jashtëm mendonin se puna me vlerësime të mbivendosura përbën sfidë dhe disa spekuluan se kjo sillte vështirësi të mëdha në respektimin e afateve.

IAL-të u shprehën pozitivisht për punën e grupeve të vlerësimit të jashtëm, duke theksuar profesionalizmin dhe organizimin cilësor të vizitave të vlerësimit të jashtëm.

Në Mbretërinë e Bashkuar, grupet e vlerësimit të jashtëm të QAA-së zakonisht përfshijnë një student që studion ose sapo ka nisur të studiojë në një IAL. Pikëpamja shtesë për standardet akademike, dhe në veçanti për cilësinë e përvojës së studentëve të ofruar nga vlerësuesi student shpeshherë përbën kontribut të vlefshëm për punën e grupit të vlerësimit të jashtëm.

Rekomandim: APAAL-i të marrë parasysh përfshirjen e studentëve në vlerësime në të ardhmen

Vlerësimi i kryevlerësuesve

Përgjigjet e anketimit treguan se në vlerësimet e tyre, vlerësuesit e jashtëm u kishin dhënë notë maksimale (pozitive) Kryevlerësuesve. Komentet kampion përfshijnë "Kryevlerësuesit ishin të shkëlqyer dhe shumë të përkushtuar", "shembull i mirë i menaxhimit me mirëkuptim përballë

vështirësive”, dhe “gjatë përpilimit të raporteve ai ishte shumë i sjellshëm dhe i efektshëm”. Vlerësuesit e jashtëm vërejtën trysninë me të cilën janë përballur kryevlerësuesit gjatë kryerjes së detyrës së tyre në një mjedis të panjohur, dhe u shprehën pozitivisht për përballimin e këtyre sfidave. Vlerësuesit e jashtëm shqiptarë thanë fjalë të mira edhe për punën e Kryevlerësuesve, zakonisht duke shprehur mendimin se e kanë bërë punë shumë të mirë.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm në përgjithësi

Kryevlerësuesit u shprehën pozitivisht në vlerësimin e grupeve me të cilët punuan, duke përfshirë konsultimin e evidencave, pjesëmarrjen në diskutime, gjykimet, dhe identifikimin e praktikave të mira, rekomandimeve dhe pohimeve.

Roli i vlerësuesve të jashtëm shqiptarë

Vlerësuesit e jashtëm të QAA-së e konsideruan rolin e vlerësuesve shqiptarë si tejet të dobishëm për procesin, si në përmirësimin e perceptimit të grupit për sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri, ashtu dhe me ndihmën në përkthim në mbledhje edhe në dokumentet e marra. Shumë vlerësues të jashtëm vërejtën se puna me kolegët shqiptarë ishte një nga tiparet më pozitive të procesit të vlerësimit të jashtëm. Megjithatë, në një rast, një grup i konsideroi shumë të dobëta aftësitë gjuhësore në anglisht të njërit prej vlerësuesve të jashtëm shqiptarë, gjë që binte në kundërshti me kërkesat e Manualit, dhe kjo solli tension në grup.

Vlerësimi i Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm

Rolin e Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm për të gjitha vlerësimet e luanin dy persona, dhe kjo solli një qasje koherente dhe të qartë ndaj rolit. Vlerësuesit e jashtëm e theksuan dhe e mirëpritën këtë aspekt.

Kryevlerësuesit dhe vlerësuesit e jashtëm u shprehën shumë pozitivisht për ndihmën dhe këshillimin e ofruar nga menaxherët e vlerësimit të jashtëm, që konsideroheshin “të shkëlqyer” sipas njërit prej reagimeve të ofruara, dhe “jashtëzakonisht të dobishëm në drejtimin e diskutimeve kur iu kërkohej të kontribuonin dhe të ndërhnin vetëm kur vlerësuesit e jashtëm po i tejkalonin kompetencat e tyre”. Disa kishin bërë një mbledhje paraprake virtuale me Menaxherin e Vlerësimit të Jashtëm dhe kjo kishte qenë e dobishme, ndërsa të tjerë nuk e kishin bërë këtë gjë dhe nuk ishin në dijeni që kjo mund ose duhej të kishte ndodhur. Mbase formalizimi i mbledhjeve të tilla në të ardhmen do të ishte i dobishëm.

Disa kryevlerësues dhanë reagime që tregonin se ishin të pësjtjelluar rreth rolit të Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm, dhe se do të ishte mirë të trajtoheshin dhe të qartësoheshin më shumë për sa i përket ndarjes së përgjegjësisë.

Vlerësuesit e jashtëm u shprehën pozitivisht për punën e Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm dhe i konsideruan këshillat për përgatitjen e programeve si të vyera. Vlerësuesit e jashtëm shqiptarë e mbështetën bashkërisht punën e Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm.

Ofruesit thanë fjalë pozitive për marrëdhënien ndërmjet IAL-ve dhe Menaxherëve të Vlerësimit të Jashtëm, s’duke u shprehur se ata ishin të dobishëm dhe profesionistë në përmbushjen e detyrës.